



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 18.9. 2018

RAPORT

MBI VLERËSIMIN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”

- Hyrje

Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr.74/2018 të datës 31.5.2018, ka miratuar rregullat për krijimin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e këtij komisioni.

Komisioni i Pavarur do të monitorojë si dhe do të ndjekë ecurinë e zbatimit të detyrimeve ligjore nga institucionet respektive, brenda afateve ligjore, si dhe do të bëjë koordinimin midis institucioneve dhe organeve që ngarkohen me zbatimin e ligjit 115/2016.

- Shqyrtimi i kandidaturave nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Bazuar në Vendimin nr.74, datë 31.5.2018 të Kuvendit, në përfundim të afatit të parashikuar në shpalljen për hapjen e procedurës së aplikimit për pesë vende vakante për anëtarë të Komisionit të Pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016, kanë paraqitur shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues kandidatët:

1. Andi Muratej
2. Artan Spahiu
3. Gëzim Allaraj
4. Ilir Kadiu
5. Irena Nino

6. Lindita Rusmali
7. Saimir Shehri
8. Saimir Vishaj
9. Suzana Pasha (Hoti)

Komisioni për Çështjet Ligjore, bazuar në pikën XII të Vendimit nr.74, datë 31.5.2018 të Kuvendit, në datën 10.9.2018 zhvilloi një seancë dëgjimore publike për të bërë vlerësimin e meritës së kandidatëve dhe të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve për t'u zgjedhur.

Sipas vendimit nr.74, datë 31.5.2018 të Kuvendit, anëtar i Komisionit të Pavarur mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të mos jetë larguar nga detyra e gjyqtarit apo prokurorit, me dorëheqje, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, apo jurist në nivele drejtuese në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

- a) vjetërsisë në profesion;
- b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës;
- c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e së drejtës;
- ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike.

Në përfundim të seancës dëgjimore dhe bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët për përmbushjen e kushteve ligjore, të dhënat për secilin nga kandidatët janë si më poshtë:

1. Z.Andi Muratej, është shtetas shqiptar, i diplomuar në vitin 2001, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga librezja e punës dhe CV personale e paraqitur rezultojnë se kandidati plotëson kriterin e 15 viteve punë si jurist, si dhe nuk ka asnjë masë disiplinore

ndaj tij. Nuk rezulton që kandidati të ketë qenë gjyqtar ose prokuror, pra nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe ndonjë mase disiplinore si pasojë e tij.

Kandidati ka deklaruar se nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit. Nga dokumentacioni rezulton se ndaj tij nuk ka një procedim penal në proces apo të jetë dënuar për kryerjen e një vepre penale.

Nga dosja rezulton se kandidati ka pasur veprimtari në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe kualifikime dhe trajnime në fushën e së drejtës, brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu, me vetëdeklarim, kandidati ka paraqitur deklaratat në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ku rezulton se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

2. Z.Artan Spahiu, është shtetas shqiptar, i diplomuar në Degën Juridik pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, në vitin 1999. Është Diplomuar me gradën shkencore “Doktor”, në profilin e drejtë biznesi, pranë Universitetin European të Tiranës.

Nga librezja e punës dhe CV personale e paraqitur rezulton se kandidati plotëson kriterin e 15 viteve punë si jurist, si dhe nuk ka asnjë masë disiplinore ndaj tij. Nuk rezulton që kandidati të ketë qenë gjyqtar ose prokuror, pra nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe ndonjë mase disiplinore si pasojë e tij.

Kandidati ka deklaruar se nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit.

Nga dokumentacioni rezulton se ndaj tij nuk ka një procedim penal në proces apo të jetë dënuar për kryerjen e një vepre penale.

Nga dokumentacioni rezulton se kandidati është certifikuar si auditues i brendshëm në sektorin publik, si dhe është licencuar si ndërmjetës në vitin 2016. Ka një eksperiencë shumë të pasur të botimeve në revistat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ka qenë pjesëmarrës në një numër relativisht të lartë konferencash ndërkombëtare. Është bashkëautor në monografi dhe një cikël leksionesh në fushën e të drejtës.

Me vetëdeklarim, kandidati ka paraqitur deklaratat në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ku rezulton se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

3. Z.Gëzim Allaraj, është shtetas shqiptar, i diplomuar në vitin 1998, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga CV personale dhe vërtetimi i Dhomës së Avokatisë rezulton se kandidati plotëson kriterin e 15 viteve punë si jurist, si dhe nuk rezulton asnjë

masë disiplinore ndaj tij. Nuk rezulton që kandidati të ketë qenë gjyqtar ose prokuror, pra nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe ndonjë mase disiplinore si pasojë e tij.

Kandidati në kërkesën për shprehje interesi ka deklaruar se nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit. Nga dokumentacioni rezulton se ndaj tij nuk ka një procedim penal në proces apo të jetë dënuar për kryerjen e një veprë penale.

Gjithashtu, me vetëdeklarim, kandidati ka paraqitur deklaratat në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ku rezulton se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

4.Z. Ilir Kadiu është shtetas shqiptar, i diplomuar në vitin 1999, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga librezja e punës dhe CV personale e paraqitur rezulton se kandidati plotëson kriterin e 15 viteve punë si jurist, si dhe nuk ka asnjë masë disiplinore ndaj tij. Nuk rezulton që kandidati të ketë qenë gjyqtar ose prokuror, pra nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe ndonjë mase disiplinore si pasojë e tij.

Kandidati ka diplomë Master Profesional “Drejtësi/E drejta Administrative”, të vitit 2011, në UET, si dhe certifikatë si auditues i brendshëm në sektorin publik. Ka paraqitur dhe disa certifikata të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit.

Nga dokumentacioni rezulton se ndaj tij nuk ka një procedim penal në proces apo të jetë dënuar për kryerjen e një veprë penale.

Me vetëdeklarim, kandidati ka paraqitur deklaratat në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ku rezulton se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

5. Znj. Irena Nino, është shtetase shqiptare, e diplomuar në vitin 1985, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga librezja e punës dhe CV personale e paraqitur rezulton se kandidatja plotëson kriterin e 15 viteve punë si jurist, si dhe nuk rezulton asnjë masë disiplinore ndaj saj. Kandidatja ka deklaruar se nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit.

Kandidatja ka dhënë dorëheqjen si prokurore në vitin 2004, dhe nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit. Ka marrë pjesë në disa trajnime brenda dhe jashtë vendit.

Me vetëdeklarim, kandidatja ka paraqitur deklaratat në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ku rezulton se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

6. Znj. Lindita Rusmali, është shtetase shqiptare, e diplomuar në vitin 1992, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga CV personale e paraqitur rezulton se kandidatja plotëson kriterin e 15 viteve punë si jurist, si dhe nuk rezulton asnjë masë disiplinore ndaj saj.

Me vetëdeklarim, të paraqitur në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit.

Ka ushtruar profesionin e juristit pa ndërprerje prej 26 vitesh. Nga dokumentacioni rezulton se kandidatja ka kualifikime pasuniversitare dhe trajnime në fushën e së drejtës, brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu, kandidatja ka deklaruar se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

7. Z. Saimir Shehri, është shtetas shqiptar, i diplomuar në vitin 1999, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga librezja e punës nuk rezulton asnjë masë disiplinore ndaj tij. Nuk rezulton nga CV që kandidati të ketë qenë gjyqtar ose prokuror, pra nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe ndonjë masë disiplinore si pasojë e tij.

Nga dokumentacioni rezulton se ndaj tij nuk ka një procedim penal në proces apo të jetë dënuar për kryerjen e një veprë penale.

Me vetëdeklarim, kandidati ka deklaruar se nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit.

Gjithashtu, me vetëdeklarim, kandidati ka paraqitur deklaratat në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ku rezulton se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

8. Z. Saimir Vishaj është shtetas shqiptar, i diplomuar në vitin 1996, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga CV personale dhe nga vërtetimi i lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë rezulton se kandidati plotëson kriterin e 15 viteve punë si jurist, si dhe nuk rezulton asnjë masë disiplinore ndaj tij. Nuk rezulton që kandidati të ketë qenë gjyqtar ose prokuror, pra nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe ndonjë masë disiplinore si pasojë e tij.

Kandidati ka deklaruar se nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit.

Nga dokumentacioni rezulton se ndaj tij nuk ka një procedim penal në proces apo të jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale.

Kandidati është Kryetar i Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë dhe një nga anëtarët themelues të saj. Nga viti 2009 e në vazhdim, është anëtar i Këshillit Kombëtar të Dhomës Kombëtare të avokatisë, dhe nga viti 2013 e në vazhdim anëtar i Komitetit Disiplinor të Avokatëve. Ka qenë pjesëmarrës në grupet e punës nga Ministria e Drejtësisë dhe KLD për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penal si dhe në grupet e punës për ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, në kuadrin e Reformës në Drejtësi. Nga viti 2016 e në vazhdim është pedagog i brendshëm në Universitetin Luarasi, pedagog i jashtëm në UET, Shkollën e Avokatisë, Universiteti Wisdow, si dhe anëtar i Rrjetit të Avokatisë së Ballkanit.

Me vetëdeklarim, kandidati ka paraqitur deklaratat në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ku rezulton se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

9. Znj.Suzana Pasha (Hoti) është shtetase shqiptare, e diplomuar në vitin 1997, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga librezja e punës dhe CV personale e paraqitur rezulton se kandidatja plotëson kriterin e 15 viteve punë si juriste, si dhe nuk rezulton asnjë masë disiplinore ndaj saj. Kandidatja ka deklaruar se nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike dhe nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit.

Referuar librezës së punës rezulton se kandidatja ka ushtruar detyrën e ndihmësgjyqtares deri në 31 Maj 2000, dhe nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit.

Gjithashtu, me vetëdeklarim, kandidatja ka paraqitur deklaratat në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, nga ku rezulton se nuk është në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

- Vlerësimi dhe votimi i kandidatëve nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Në mbledhjen e datës 18.9.2018, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në pikën XII të Vendimit nr.74, datë 31.5.2018 të Kuvendit, filloi shqyrtimin dhe vlerësimin e meritës së kandidatëve si dhe të përmbushjen së kriterëve për t’u zgjedhur anëtarë të Komisionit të Pavarur të Monitorimit.

Relatorja, znj.Klotilda Bushka, paraqiti para Komisionit, për secilin nga kandidatët, vlerësimin lidhur me përmbushjen e kriterëve formale për të qenë anëtarë të Komisionit të Pavarur të Monitorimit. Në vlerësimin e relatores, të gjithë kandidatët plotësojnë kriteret

formale të parashikuara në Vendimin nr.74 Të Kuvendit, dhe nuk ndodhen në kushtet e pengesës ligjore për të kandiduar.

Gjatë diskutimit për kandidaturat dhe vlerësimit të tyre, deputetët morën në konsideratë dhe prezantimin e kandidatëve gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 10.9.2018.

Bazuar në procedurën e parashikuar në Vendimin nr.74 Të Kuvendit, Kryetari i Komisionit hodhi për votim, emër për emër, sipas rendit alfabetik të emrit, të gjithë kandidatët. Në përfundim të votimit, rezultuan të votuar më shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, kandidatët;

1. Andi Muratej
2. Artan Spahiu
3. Gëzim Allaraj
4. Ilir Kadiu
5. Irena Nino
6. Lindita Rusmali
7. Saimir Shehri
8. Saimir Vishaj
9. Suzana Pasha (Hoti)

Pas përfundimit të procesit të votimit, Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi listën përfundimtare me emrat e 9 kandidatëve, dhe vendosi përcjelljen e kandidaturave për votim seancës plenare, në përputhje me parashikimet e pikës XIII të Vendimit nr.74, datë 31.5.2018 të Kuvendit.

R E L A T O R E

KLOTILDA BUSHKA

KRYETAR

ULSI MANJA